

**AKT - THEMELIMI
I
SHOQERISE SE SIGURIMIT
SIGAL LIFE sh.a**



Ne te nenshkruarit:

1. Shyqyri Duraku, i biri i Alushit lindur ne Kukës me 8.12.1954 dhe me banim Tirane, Rruga e Kavajes Nr 58, me numer pasaporte 06087763.
2. Llazar Angjeli, i biri i Sotirit, lindur me 05.02.1940 dhe me banim ne Tirane, Rruga e Durrësit pallati 124/2-15 me numer pasaporte 0085140.
3. Avni Ponari i biri i Rexhepit, lindur me 28.07.1957 dhe me banim ne Tirane, Rr "N.Tupe" pall 13, me nr pasaporte 1996645.
4. Edvin Hoxhaj i biri i Skenderit, lindur me 30.04.1966 me banim ne Tirane, Rr "Dervish Hima" P.114, Shk.2 , me numer pasaporte 124770.
5. Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve me seli ne USA dhe me zyre perfaqesimi ne "Green Park" kompleks, kulla 2 kati XII Tirane, perfaqesuar nga Z. Jeffrey T.Griffin, shtetas Amerikan, lindur ne Georgia (USA) me 14.06.1944, mbajtes i pasaportes me nr Z8236285 ne cilesine e Presidentit & CEO te AAEF (me poshte e quajtur "Fondi").

Te mbledhur sot me date 22.03.2004, vendosem te themelojme shoqerine anonime "SIGAL LIFE" sh.a sipas percaktimeve ne kete akt themelimi dhe statut.
Per kete arsye ne vendosem sa me poshte:

Neni 1

Themeluesit do te krijojne nje shoqeri anonime e cila do te quhet "SIGAL LIFE" sh.a

Neni 2


Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, Bulevardi "Zog I", pallati nr. 57.
Me vendim te asamblese se pergjithshme te aksionereve mund te ndryshohet selia, si dhe mund te hapen filjale dhe degje ne qytetet e tjera te Shqiperise.

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete e pacaktuar.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete sigurimi i jetes dhe ndalimi mbi bazen e ligjit 8081 "Per veprimtarin e sigurimit dhe te risigurimit" si dhe legjislacionit mbi shoqerite tregtare dhe te gjith dispozitat ligjore qe rregullojne aktivitetin sigurues dhe risigurues te jetes.



Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 125 milion leke, i ndare ne 125 mije aksione nominative te themelueseve te shoqerise, te cilat jane te se njejtës kategori dhe me vlere nominale 1000 (nje mije) leke. Aksionet jane te numruara nga nje ne 125 000 perfshire numerin e fundit te aksionit.

Perberja e kapitalit te shoqerise eshte si me poshte:

Emri,mbiemri	perqindja	Nr i aksioneve
1. Shyqyri Duraku	26.40%	33.000
2. Llazar Angjeli	26.40%	33.000
3. Avni Ponari	29.04%	36.300
4. Edvin Hoxhaj	6.16%	7.700
5. Fondi shqiptaro amerikan i ndermarrjeve	12.00%	15.000

Neni 6

Shoqeria do te kete keto organe drejtuese:

- Asambleja e pergjithshme e aksionereve
- Keshilli Mbikqyres
- Drejtoria

Neni 7

Keshilli Mbikqyres i shoqerise do te perbehet nga 6 vete, te cilet jane caktuar si me poshte nga mbledhja themeluese e shoqerise:

1. Avni Rexhep PONARI	Kryetar
2. Shyqyri Alush DURAKU	Anetar
3. Llazar Sotir ANGJELI	Anetar
4. Spartak Shaqo GJINI	Anetar
5. Dashamir Bektash KORE	Anetar
6. Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve me perfaqesues Jeffrey T.GRIFFIN	Anetar

Ky keshill do te ushtroje veprimtarin e tij sipas afatit dhe percaktimeve te bera ne statutin e shoqerise.

Neni 8

Drejtori i Pergjithshem i shoqerise eshte caktuar, ne mbledhjen e pare themeluese te saj, Z.Edvin HOXHAI.

Funksionet dhe kompetencat e Drejtorit te Pergjithshem te shoqerise do te percaktohen ne statut.

Neni 9

Shoqeria autorizon Z.Edvin Hoxhaj ne cilesine e Drejtorit te Pergjithshem te kryej te gjitha procedurat per licensim te aktivitetit prane KMS si dhe procedurat ligjore prane Gjykates per rregjistrimin e shoqerise.

Neni 10


Kapitali themeltar i shoqerise do te derdhet ne Banken Amerikane te Shqiperise dhe ngarkohet Drejtori i Pergjithshem te vertetoj derdhjet e kapitalit nga secili aksioner, si dhe tu jape vertetime secilit per shumat e derdhura.

Kapitali themeltar ne krijim e siper te shoqerise do te derdhet nga themeluesit ne banka te nivleit te dyte sa nje e dyta e pjeses takuese vertetuar me dokumeta perkates.


Dispozita te detajuara do te percaktohen ne Statutin e Shoqerise.

AKSIONERET


Shyqyri DURAKU

Shyqyri Duraku



**Fondi Shqipetaro-Amerikan i Ndermarrjeve
Perfaqesuar nga Jeffrey T.Griffin**



Llazar ANGJELI

Llazar Angjeli


Avni PONARI

Avni Ponari


Edvin HOXHAI

Edvin Hoxhaj
